

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

PËR PROGRAMIN E SHKËMBIMIT AKADEMIK FULBRIGHT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësuar nga Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (më poshtë referuar së bashku si "Pjesëmarrësit" dhe në njëjës referuar përkatësisht si "Pjesëmarrësi shqiptar" dhe "Pjesëmarrësi amerikan");

Me dëshirën për të zhvilluar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe nxitjen e mirëkuptimit dhe miqësisë së ndërsjellë ndërmjet dy kombeve tona;

Kanë arritur në mirëkuptim sa më poshtë:

SEKSIONI 1

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (referuar më poshtë si MM) është të forcojë dhe zhvillojë lidhjet ndërmjet Pjesëmarrësve në procesin e zbatimit të Programit të Shkëmbimit Akademik Fulbright (referuar më poshtë si "Programi Fulbright") në arsim, kulturë, shkencë dhe punë kërkimore, bazuar në kushte me përfitim të ndërsjellë.

SEKSIONI 2

Me pjesëmarrjen e tyre në Programin Fulbright, Pjesëmarrësit shpresojnë nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dy vendet dhe inkurajimin e përmirësimit të kualifikimeve të profesionistëve akademikë, studiuesve, pedagogëve dhe studentëve, si dhe nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore.

SEKSIONI 3

Koordinatori i këtij MM, në emër të Pjesëmarrësit amerikan, është Seksioni për Marrëdhëniet me Publikun i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë (më poshtë referuar si "PAS Tiranë") dhe në emër të Pjesëmarrësit shqiptar, është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (më poshtë referuar si "Ministria").

SEKSIONI 4

Gjatë zbatimit të këtij MM, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të koordinojë si vijon: menaxhimin e Programit Fulbright në Republikën e Shqipërisë; organizimin e

përzgjedhjes fillestare të kandidatëve për Programin Fulbright; zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe shkencore; si dhe analizën e potencialit për shkëmbime akademike shtesë.

A. Pjesëmarrësit kanë për qëllim që përzgjedhja e kandidatëve për Programin Fulbright të jetë e hapur, bazuar në meritë dhe në përputhje me kriteret e vendosura nga Bordi i Bursave të Huaja J. William Fulbright të Shteteve të Bashkuara, të cilat gjenden në adresën: <http://fulbright.state.gov/fsb/program-policies>. PAS Tirana mund të vendosë kriteret më specifike, në përputhje me politikat e programit Fulbright, të cilat njoftohen publikisht në momentin që bëhet thirrja për aplikim.

SEKSIONI 5

A. Çdo vit, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë studentë, staf akademik dhe profesionistë nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për të studiuar në Universitetet e SHBA dhe të koordinojë pjesëmarrjen e studentëve, stafit akademik dhe profesionistëve të Shteteve të Bashkuara në studim, kërkim, ose trajnime akademike në institucionet akademike apo institucionet e tjerë të Republikës së Shqipërisë.

B. Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të delegojë një përfaqësues për të marrë pjesë në Komisionin Përzgjedhës të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për të zgjedhur studentët, stafin akademik dhe profesionistët që aplikojnë për Programin Fulbright.

SEKSIONI 6

Çdo vit, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë studentë nga Republika e Shqipërisë për të studiuar në universitetet e Shteteve të Bashkuara për periudha nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzetekatër (24) muaj.

SEKSIONI 7

Çdo vit, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë staf akademik dhe profesionistë nga Republika e Shqipërisë për të dhënë leksione dhe/ose për të zhvilluar kërkime shkencore në universitetet dhe institucionet kërkimore të Shteteve të Bashkuara dhe të koordinojë punën kërkimore dhe/ose leksionet e personelit akademik nga Shtetet e Bashkuara në institucionet arsimore, institutet dhe qendrat ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit të Republikës së Shqipërisë për periudha kohore që variojnë nga tre (3) deri në nëntë (9) muaj.

SEKSIONI 8

Çdo vit, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë staf akademik dhe profesionistë nga Republika e Shqipërisë për të marrë pjesë në programe të zhvillimit profesional dhe programe të shkëmbimit në Shtetet e Bashkuara.

SEKSIONI 9

Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të koordinojë financimin dhe zbatimin e Programit Fulbright në Republikën e Shqipërisë. Byroja për Çështjet e Arsimit dhe Kulturës e Departamentit Amerikan të Shtetit planifikon të financojë studimet, kostot e jetesës, kostot e udhëtimit dhe sigurimin shëndetësor për studentët, stafin akademik dhe profesionistët amerikanë që marrin pjesë në Programin Fulbright në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 10

A. Në bashkërendim me Pjesëmarrësin amerikan, Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të ofrojë mbështetjen financiare në shumën prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro në vit, për të mbështetur kostot e programit Fulbright Student me qëllim krijimin e më shumë mundësive për studentët, stafin akademik dhe profesionistët që marrin pjesë në Programin Fulbright.

B. Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim ta fillojë dhënien e këtij kontributi në vjeshtën e vitit 2019 dhe ta vazhdojë deri në vitin akademik 2024-2025. Pjesëmarrësi shqiptar mund të konsiderojë bashkëpunimin e mëtejshëm me Pjesëmarrësin amerikan përmes akordimit të burimeve shtesë nga fondi i bursave të ekselencës në Republikën e Shqipërisë për studentët shqiptarë në fushat me interes të veçantë për Pjesëmarrësin shqiptar.

SEKSIONI 11

Në zbatimin e këtij MM, Pjesëmarrësit planifikojnë të shkëmbejnë informacion rreth institucioneve arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore në Programin Fulbright për tu dhënë përparësi nevojave arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore të këtyre institucioneve.

SEKSIONI 12

Në zbatimin e këtij MM, Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të inkurajojë institucionet qeveritare, arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore që të mundësojnë kushtet më të favorshme për zbatimin e Programit Fulbright në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 13

Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të koordinojë në kohë aprovimin dhe lëshimin e dokumenteve ligjorë të nevojshëm për studentët, stafin akademik dhe profesionistët amerikanë, për të marrë pjesë në Programin Fulbright në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 14

Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të punojë me institucionet e tij arsimore, shkencore dhe kërkimore që pranojnë pjesëmarrës të Programit Fulbright, me synim mundësimin e hapësirave të duhura të punës dhe pajisjeve përkatëse të nevojshme për kërkimet akademike, vendosjen e këshilltarëve sipas nevojave, garantimin e aksesit në bibliotekat dhe arkivat e institucionit pritës dhe për të lejuar pjesëmarrësit e Programit Fulbright të marrin pjesë në programe, kurse, leksione dhe seminare të përzgjedhura.

SEKSIONI 15

Pjesëmarrësit kanë për qëllim që shkëmbimet akademike që parashikohen në këtë MM, të zbatohen në përpËthje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës duke përfshirë dhe ato që lidhen me disponueshmërinë e fondeve.

SEKSIONI 16

Pjesëmarrësit kanë për qëllim të shkëmbejnë informacion rreth zbatimit të këtij MM.

SEKSIONI 17

Për zbatimin e këtij MM, Ministria ka për qëllim të nënshkruajë një Marrëveshje me Institutin e për Edukimin Ndërkombëtar (më poshtë IIE), sa i përket modaliteteve dhe procedurave të lëvrimin të fondeve të parashikuara në Seksionin 10 të këtij MM. IIE është përgjegjës për administrimin e të gjitha fondeve të Departamentit Amerikan të Shtetit për programin Fulbright në Shqipëri.

SEKSIONI 18


A. Ky MM ka për qëllim të fillojë pas njoftimit të Pjesëmarrësve nga autoritetet kompetente për përfundimin e të gjitha procedurave të nevojshme të brendshme dhe të vijojë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

B. Ky MM mund të modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të dy Pjesëmarrësve.

C. Ky MM mund të ndërpritet në çdo kohë nga njëri Pjesëmarrës duke informuar Pjesëmarrësin tjetër me shkrim. Pjesëmarrësi, i cili dëshiron të ndërpresë Memorandumin, duhet të përpigjet të njoftojë me shkrim Pjesëmarrësin tjetër të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj para mbi qëllimin e tij për ndërprerjen.


Nënshkruar në New York këtë ditë 25 të muajit shtator 2019, në dublikatë, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Pjesëmarrësit kanë për qëllim që teksti në gjuhën angleze të jetë versioni zyrtar i këtij MM.

Për Qeverinë e
Shteteve të Bashkuara të Amerikës



Marie Royce, Ndihmës Sekretare e Shtetit
Për Çështjet e Arsimit dhe Kulturës

Për Qeverinë e
Republikës së Shqipërisë



Gent Cakaj, Ministër i Jashtëm në
Detyrë